



Albanisch

Fletë udhëzuese: Njoftime / Rregulla të shkollës / Marrëveshje

Të dashura nxënëse, të dashur nxënës!

Këtë vit shkollor ju do të ndiqni një ofertë-urë, duke dëshiruar që në këtë mënyrë të përmirësoni shanset tuaja për të përvetësuar një profesion. Këtë synim ju do t'a arrini, në qoftë se do të jeni të gatshëm për t'u angazhuar seriozisht dhe intensivisht. Ne ju urojmë gjithë të mirat dhe suksese në shkollën tonë.

Të dashur prindër!

Edhe ju shpresoni që djali juaj/vajza juaj të bëjë përparime gjatë këtij viti-urë në drejtim të zhvillimit të tij vetiak. Ne si shkollë, për të qenë të suksesshëm, kemi nevojë të ngutshme për përkrahjen tuaj. Udhëzimet dhe marrëveshjet e mëposhtme përbëjnë bazën e një bashkëpunimi të frytshëm.

Viti shkollor

Nëpërmjet regjistrimit në shkollë nxënëset dhe nxënësit marrin përsipër detyrimin **për të ndjekur gjithë vitin shkollor.**

Lejet

Në rast se ju nuk do të keni mundësi të ndiqni shkollën për arsye që mund të parashikohen, duhet të kërkonit leje. Formularët për kërkimin e lejeve do t'i gjeni pranë mësueses së klasës/mësuesit të klasës. Lutjet duhet të dorëzohen së paku 8 ditë para datës së lejes.

Nxënëset dhe nxënësit e shkollës sonë e kanë kryer kohën e shkollës së detyrueshme. Ata tashmë janë në pozicionin e një nxënësi në profesion. Prandaj lejet do të jepen vetëm në raste të rralla dhe tepër të rëndësishme.

Zgjatja e pushimeve ose fillimi i parakohshëm i pushimeve do të lejohen vetëm në qoftë se me anën e një vërtetimi të punëdhënësit të prindit dëshmohet se pushimet nuk mund të merren në një kohë tjetër. **Lutjet për shkak të tarifave më të favorshme të fluturimeve nuk do të merren parasysh.**

Veprimtari shkollor

Nxënëset/nxënësit janë të detyruar të ndjekin mësimet në të gjitha lëndët, duke përfshirë këtu edhe lëndët shtesë të zgjedhura vetë dhe kurset tremujore. Ata janë të detyruar të marrin pjesë në të gjitha ekskursionet dhe manifestimet e cilësuara si të detyrueshme nga shkolla.

Parapërgatitjet për zgjedhjen e profesionit

Përgjegjësia kryesore për parapërgatitjet për zgjedhjen e profesionit i takon vetë të rinjve si edhe prindërve të tyre. Natyrisht me këtë rast ata do të përkrahen fuqimisht edhe nga trupi mësimor. Në rast se do të do t'ju lindi ndonjë pyetje apo do të keni nevojë për ndihmë, drejtohuni me kohë mësueses së klasës/mësuesit të klasës. Po ashtu nuk do t'ju mungojë edhe ndihma e këshilltarëve për zgjedhjen e profesionit.

Rregullorja e mungesave

Frekuentimi i një oferte-urë bëhet mbi baza vullnetare. Nëpërmjet regjistrimit ju merrni përsipër detyrimin tuaj për ta ndjekur shkollën në vazhdimësi. Për këtë arsye kërkojmë që nxënëset dhe nxënësit të paraqiten me përpikmëri dhe vazhdimësi në mësim. Mungesat dhe vonesat përcaktohen në Rregulloren e Shkollës (§§ 24 – 37) të Ligjës mbi Shkollën (410.100). Në rast se një nxënëse ose një nxënës gjatë një viti shkollor bën më shumë se 14 mungesa të paarsyeshme (më shumë se 9 mungesa të paarsyeshme në oferta të kombinuara) kjo është e barazvlefshme me largimin vullnetar nga shkolla me pasojë zhdëmtimin e shpenzimeve (shih «Zhdëmtimi i shpenzimeve»).

Mungesa afatshkurtër me arsye (për shembull në raste sëmundjesh)

Në ditën e parë të mungesës suaj duhet të telefononi në shkollë ndërmjet orës 07.30 – 07.45 ose 08.30 – 08.40. Njoftoni mësuesen ose mësuesin tuaj të klasës.

Si shënohen vonesat dhe mungesat në dëftesën shkollore?

- Vonesë quhet nëse nxënësi/nxënësja nuk ndodhet në klasë në kohën e fillimit të mësimin.
- Mungesë quhet nëse nxënësja/nxënësi nuk është i pranishëm të paktën në një leksion (45 minuta). Çdo gjysëm dite shkolle llogaritet një mungesë.

Arsyetimet

Të rinjtë duhet t'ia dorëzojnë arsyetimet me shkrim mësuesit të klasës/mësueses së klasës të paktën 8 ditë mbas mungesës ose vonesës. Letra arsyetuese duhet të përmbajë arsyetimin përkatës si edhe të dhëna për kohëzgjatjen. Në rastin e të rinjve në moshë të mitur letra arsyetuese duhet të nënshkruhet edhe nga prindërit. Në rastet e mungesave të përsëritura dhe/ose për sëmundje të gjata mund të kërkohej edhe një raport mjekësor.

Mosha madhore: Nxënëset ose nxënësit që janë më të mëdhenj se 18 vjeç

Të rinjtë, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeçare, konsiderohen në moshë madhore dhe mbajnë përgjegjësi vetjake për veprimet që kryejnë ndaj të tretëve, ndaj shtetit, por edhe ndaj shkollës. Megjithatë, mësueset dhe mësuesit tanë vazhdojnë të informojnë prindërit, në marrëveshje të heshtur me rinjtë, përsa i përket ecurisë në shkollë të djalit apo vajzës së tyre. Në qoftë se të rinjtë nuk dëshirojnë që këto lloj informacionesh t'iu jepen prindërve të tyre, mund të njoftojnë me shkrim në fillim të vitit shkollor (apo mbasi të kenë mbushur moshën 18 vjeçare) mësuesin e klasës/mësuesen e klasës për t'ia kaluar Rektoratit.

Udhëzim: Vendimet e rëndësishme (largimi nga shkolla, masat disiplinore si për shembull, kërcënim për përjashtim nga shkolla) duhet t'u bëhen me dije prindërve edhe në të ardhmen.

Zhdëmtimi i shpenzimeve në rastet e largimit ose përjashtimit nga shkolla gjatë vitit shkollor

Në qoftë se gjatë vitit shkollor ndodh një largim pa miratimin e Drejtorisë së Shkollës ose një i ri përjashtohet nga shkolla për shkak të sjelljes së tij, atëhere prindërve të tij, personit të ngarkuar me edukimin ose përkatësisht të riut në moshë madhore do t'u kërkohej pagimi i shumës prej 800 franga.

Udhëzim: Ndjekja e shkollës në ofertën-urë është falas. Por shpenzimet e bëra me këtë rast kapin shumën prej 18'000 frangash në vit. Në rastet e një largimi të parakohshëm ose përjashtimi nga shkolla nuk plotësohet numri i parashikuar i nxënësve dhe shpenzimet mbeten po ato, pa qenë e mundur që një nxënëse/nxënës tjetër të përfitojë nga kjo gjë.

Ky zhdëmtim i shpenzimeve është pjesë e marrëveshjes mbi pranimin në shkollë dhe njihet si i tillë me hyrjen në shkollë.

Zentrum für Brückenangebote (ZBA)